

Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

## 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria "PE-VLA-KU" sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 7 Nentor 2005 ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Mbi Shoqëritë tregtare". NUIS –i i shoqërisë është K61716013M.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 15,600,000 Leke (pesëmbëdhjetë milion gjashtëqind mijë Leke), I cili zotërohet nga dy ortakët e tij që janë:

- Z. Vladimir PJETERGJOKAJ 53%.
- Z. Kujtim ARIFAJ 47%

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e ndërtimit.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në Rrugen "Muzakët", Pallati Vokshi, Kati 7, Tirane.

## 2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

### Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

### Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

## 2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## 3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 31.12. 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi këmbimit në vitin 2021 në krahasim me 2020 është si më poshtë:

	2021	2020
1. Monedha në euro	120.76	123.70
2. Monedha <u>dollare</u>	106.54	100.84



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

#### Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

#### Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### Instrumentat financiarë (vazhdim)

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### **Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

##### **Aktive afatgjata materiale**

###### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.


Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

###### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

##### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	0 %
Instalime teknike, makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	0 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	0 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	0 %
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	0 %

##### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative



### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

#### Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

#### Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me

detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



**PE-VLA-KU SH.P.K.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021***Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe***4. MJETE MONETARE**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Mjete monetare në Lekë	<b>158.526.068</b>	<b>60.604.712</b>
Arka	39.100.377	1.592.942
Banka	119.425.691	59.011.770
Mjete monetare në valutë	<b>19.147.623</b>	<b>9.255.085</b>
Arka	12.938.590	1.466.587
Banka	6.209.033	7.788.498
<b><u>Totali.....</u></b>	<b><u>177.673.691</u></b>	<b><u>111.841.196</u></b>

**5. LLOGARI TË ARKËTUESHME TREGTARE**

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Te arketueshme nga klientë	739.454.097	763.508.480
	<b><u>739.454.097</u></b>	<b><u>763.508.480</u></b>

**6. Te tjera Llogari te arketueshme**

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
--	------------------------	------------------------

Nr	Emertimi	Lek	LEK
1	Tatim Fitimi Gjendje	16,969,002	20.712.537
2	Tvsh gjendje	0	6.701.124
3	Pevlaku Kosove	197,965,048	198.348.000
4	Petrit Imeraj	7,422,000	7.422.000
5	Kom Prokurimeve Publike	4,400,655	4.400.655
6	Zuzana Hoxha	0	500,000
7	Eduart Mrishaj	2,474,000	2.474.000
8	Drejt Pergj Doganave	5,526,992	5.526.992
9	Interesa llogaritura	14,577,080	0
	<b>Shuma</b>	<b>249,334,777</b>	<b>246,085,308</b>

**7. Shpenzime te shtyre per per shumen 8.741.820 lek**

Perfaqesojne shpenziem te bera ne vitin 2021 , por qe l perkasin shpenzimeve te vitit ushtrimore 2022.



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

## 8.AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Gjendja e Aktiveve Afatgjata Materiale ne date 31.12.2021									
Emertimi	Toka ,terrene, troje	Ndertim.Instalime pergjithshme	Instalime teknike Makineri Pajisje	Mjete transporti	shuma	Pajisje zyre dhe orendi	Pajisje Informatike	Totali	
1	2	3	4	5	6(7+8)	7	8	9(2+3+4+5+6)	
<b>Aktive te Trupezuara</b>									
Gjendje 01.01.2021	18,573,800	20,407,960	25,280,432	139,667,582	14,421,101	2,011,165	12,409,936	218,350,875	
Shtesa	-	66,374,791	5,941,583	7,824,777	814,186	20,000	794,186	80,955,337	
<b>Shuma</b>	<b>18,573,800</b>	<b>86,782,751</b>	<b>31,222,015</b>	<b>147,492,359</b>	<b>15,235,287</b>	<b>2,031,165</b>	<b>13,204,122</b>	<b>299,306,212</b>	
Pakesime	-	-	-	3,831,355	300,687	-	300,687	4,132,042	
<b>Gjendje 31.12.2021</b>	<b>18,573,800</b>	<b>86,782,751</b>	<b>31,222,015</b>	<b>143,661,004</b>	<b>14,934,600</b>	<b>2,031,165</b>	<b>12,903,435</b>	<b>295,174,170</b>	
<b>Amortizimi</b>									
Gjendje ne 01.01.2021	-	3,851,842	16,395,147	56,691,642	7,545,509	543,448	7,002,061	84,484,140	
Shtesa llogaritur	-	-	-	-	-	-	-	-	
<b>shuma</b>	<b>-</b>	<b>3,851,842</b>	<b>16,395,147</b>	<b>56,691,642</b>	<b>7,545,509</b>	<b>543,448</b>	<b>7,002,061</b>	<b>84,484,140</b>	
Pakesime	-	-	-	1,681,521	199,205	-	199,205	1,880,726	
<b>Gjendje ne 31.12.2021</b>	<b>-</b>	<b>3,851,842</b>	<b>16,395,147</b>	<b>55,010,121</b>	<b>7,346,304</b>	<b>543,448</b>	<b>6,802,856</b>	<b>82,603,414</b>	
					-				
<b>Vlera neto 01.01.2021</b>	<b>18,573,800</b>	<b>82,930,909</b>	<b>14,826,868</b>	<b>88,650,883</b>	<b>7,588,296</b>	<b>1,467,717</b>	<b>5,407,875</b>	<b>212,570,756</b>	
<b>Vlera neto 31.12.2021</b>	<b>18,573,800</b>	<b>82,930,909</b>	<b>14,826,868</b>	<b>88,650,883</b>	<b>7,588,296</b>	<b>1,487,717</b>	<b>6,100,579</b>	<b>212,570,756</b>	
<b>Ak ne proces 31.01.2021</b>	<b>-</b>	<b>40,850,945</b>							
shtese		25,523,846							
<b>shuma 31.12.2021</b>		<b>66,374,791</b>	Kjo shume kalon ne investime AQ Ndertesa						
<b>Totali 31.12.2021</b>								<b>212,570,756</b>	





Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

- **Parapagime per aktive ne proces .**

Gjendja me 31.12.2020 per shumen 40.850.945 lek dhe perfaqeson shpenzime per Objektivin ne Vore : "Godine sherbimi dhe servis automjetesh 2/kate + mur rrethues" sipas lejes ndertimit Nr 2969/5 date 03.07.2019., ndersa ne fund te vitit 2021 ka kaluar ne AQ pasi eshte perfunduar investimi per vleren gjithsej **66.374.791 lek**

#### 9.LLOGARI TË PAGUESHMET TREGTARE

Në këtë zë janë përfshirë llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Furnitorë	771.727.359	693.775.093
	<u>771.727.359</u>	<u>693.775.093</u>

#### 6. LLOGARI TË PAGUESHME NDAJ PALËVE TË LIDHURA

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë:

Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
<b>Vladimir Pjetergjokaj</b>	121.152.319	101.152.319
<b>Kujtim Arifaj</b>	59.042.698	39.042.698
<b>shuma</b>	<b>180.195.017</b>	<b>140.195.017</b>

#### 7. DETYRIMETATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2021</u>	<u>31 dhjetor 2020</u>
Detyrimi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1.004.332	778.512
Tatimi mbi të ardhurat personale	210.686	101.959
TVSH për tu paguar	148.128	0
Tatimi mbi fitimin	0	0
Detyrime të tjera	0	0
<b>Shuma</b>	<b>1.363.146</b>	<b>880.471</b>



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

## 8. KAPITALI

	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
	Vlera e kapitalit	% e kapitalit	Vlera e kapitalit	% e kapitalit
Kujtim Arifaj	7,322,000	47%	7,322,000	47%
Vladimir Pjetergjokaj	8,268,000	53%	8,268,000	53%
<b>Totali</b>	<b><u>15,600,000</u></b>	<b><u>100%</u></b>	<b><u>15,600,000</u></b>	<b><u>100%</u></b>

## 9. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Të ardhura nga ndërtimet	1.096.041.249	119.288.217
Të ardhura nga prodhimi dhe shitje AQ	25.523.846	42.477.863
<b>Totali</b>	<b><u>1.121.565.095</u></b>	<b><u>161.766.080</u></b>

## Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne

Qarkullim i tatueshëm	1.121.565.095
Shtohen te ardhurat interesave	14.577.080
Shtohet fitimi etj	62.379
Shtohen te ardhurat nga këmbimet valutore	4.798.485
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>1.141.003.039</b>
Sipas Kontabilitetit.	1.141.003.039
<b>Diferenca</b>	<b>0</b>



**PE-VLA-KU SH.P.K.****Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe*

**10. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë: të ardhura nga shitja e aseteve dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u></b>	<b><u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u></b>
Të ardhura nga shitja AAGJM	1.764.617	3.491.140
Prodhimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
Shpen nga këmbimet valutore për marrëdhënie tregtare	0	0
	<b><u>1.764.617</u></b>	<b><u>3.491.140</u></b>



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

### 11.LËNDË TË PARA DHE MATERIALE TËKONSUMUESHME

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave dhe lëndëve të para që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
1.Blerje material	217.675.888	40.821.929
2.Te tjera shpenzime	823.464.677	86.350.111
<b>Shuma</b>	<b>1.041.140.565</b>	<b>127.172.040</b>

### 11. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

		<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Llogari	Emertimi	2021	2020
641	Pagat dhe shperblimet e personelit	46,821,500	34,900,000
644	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	7,429,747	5,513,191
	<b>Shuma</b>	<b>54,251,247</b>	<b>40,413,191</b>



PE-VLA-KU SH.P.K.

**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

*Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe*

**12. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI**

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 paraqiten si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime amortizimi	<u>0</u>	<u>564.110</u>
	<u>0</u>	<u>564.110</u>



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

### 13. SHPENZIME TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

6040	Energji elektrike	266,454
6044	Uje	139,722
608010	Perkthime	1,394,729
61100	Shpen Noteriale	2,025,875
61601	Sigurime te ndryshme	2,398,082
608001	Blerje kancelarina	389,336
608006	Blerje boje dhe sherb Fotokopjuesin	432,808
62601	Shpen Telefoni Vodafon	1,269,753
634	Taksa dhe tarifa vendore	2,119,832
635	Taksa e regjistrimit	1,106,442
6271	Transporte per blerje	1,167,633
628	Sherbime bankare	347,124
657	shpenzime materiale qe nuk njihen	7,485,110
618	shpenzime te tjera	1,652,013
	<b>Totali</b>	<b>22,194,912</b>

### 14. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>
Shpenzime interesi,	0	0
Të ardhura nga interesi	15.038.844	383.900
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	<u>0</u>	<u>-159.807</u>
<b>Shuma</b>	<b><u>15.038.844</u></b>	<b><u>-224.093</u></b>

### 15. TATIMI MBI FITIMIN

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020:

	<u>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2021</u>	<u>Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020</u>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b><u>17.224.931</u></b>	<b><u>-18.297.024</u></b>
Shpenzime të panjohura	<u>7.731.969</u>	<u>0</u>
<b>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</b>	<b>24.956.900</b>	<b>-18.297.024</b>
Tatim fitimi @15%	3.743.535	0
<b>Fitim/humbje e vitit</b>	<b><u>13.481.396</u></b>	<b><u>-18.297.024</u></b>



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

## 16. PALËT E LIDHURA

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, për shembull aksionerët e shoqërisë, dhe njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose që kanë një ndikim të konsiderueshëm nga palët e tilla. Politikat e tarifimit dhe kushtet e këtyre transaksioneve janë aprovuar nga manaxhimi.

Balancat me palët e lidhura të përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021		31 dhjetor 2020	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
PE-VLA-KU Kosovë	197.965.048	0	198.348.000	0
Dividend per tu paguar		0	0	20.013.117
	<b>197.965.048</b>	<b>0</b>	<b>0 198.348.000</b>	<b>20.013.117</b>



Vlerat janë në lek, përveç kur shprehet ndryshe

## 25. ANGAZHIME DHE PASIGURI

### Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2021 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

### Detyrimet tatimore



Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

## 26. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT FINACIAR

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasdatës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

**ADMINISTRATORI**

**Vladimir Pjetergjokaj**

**Hartuesi i Pasqyrave Financiare**

**Gjovalin Fusha**

